

Akt Themelimi

I shoqërisë tregtare “PASHA RENTAL” sh.p.k

Sot më datë 03.06.2025, unë i nënshkruari:

1. Ergys Pasha

me vullnetin tim të lirë dhe të plotë në mbështetje të Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare “ hartoj këtë Akt Themelimi të Shoqërisë “PASHA RENTAL “ sh.p.k, si më poshtë vijon:

1. FORMA LIGJORE

“PASHA RENTAL “ sh.p.k është një shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar.

2. ORTAKËT THEMELUES

Ortaku themelues i shoqërisë tregtare është :

a. Ergys Pasha

3. OBJEKTI

Shoqëria do të krijohet me qëllim :

- Makina me qira, Shit-Blerje Automjetesh, lavazh dhe parking.

4. SELIA E SHOQËRISË

Selia e shoqërisë tregtare “PASHA RENTAL“ SHPK do të jetë në adresën: Durrës, Krujë, RINAS në zonën kadastrale 3183 dhe numër pasurie 58/17.

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj , të hapë zyra përfaqësie , degë , të krijojë filiale në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë , vetëm me vendim të asamblesë dhe ortakëve të saj .

Shoqëria ka vulen e saj me madhesi te zakonshme, me tekstin tretë saj .

5. KOHËZGJATJA

Shoqëria krijohet për të vepruar për gjithë kohën e përcaktuar për sa kohë do ketë treg në dhënien e makinave me qira, parkingu dhe aktivitetet të lidhur me to.

6. KAPITALI I SHOQËRISË

Kapitali themeltar i shoqërisë tregtare “PASHA RENTAL “ sh.p.k është 100.000 (*njëqind mijë*) lekë

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë tregtare mund të shtohet ose të pakësohet (por jo nën vlerën e kapitalit themeltar fillestar).

7. ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME ORTAKËVE DHE PËRFAQËSUESI LIGJOR

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve të shoqërisë tregtare “PASHA RENTAL“ sh.p.k është edhe organi më i lartë i saj.

Përfaqësuesi ligjorë i shoqërisë do të jetë _ Ergys Pasha.

8. DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

8.1 Shoqëria do të administrohet nga 1 (një) administrator i vetëm i emëruar dhe i pandryshueshmër në përputhje me këtë statut për të gjithë kohëzgjatjen e shoqërise.

8.2 Administratori i Shoqërisë mund të shkarkohet nga pozicioni që ka në Shoqëri në çdo kohë nga Asambleja e Ortakëve me Shumicë të Zakonshme. Në asnjë rast ortakëve nuk i duhet të justifikojnë apo provojnë se cilat janë shkaqet për të cilat ata shkarkojnë administratorin. Në çdo rast janë ortakët ata të cilët vlerësojnë se ka shkaqe të arsyeshme për shkarkimin e administratorit

8.3 Administratori ka të drejtë të përfaqësojë Shoqërinë në mënyrë të plotë për administrimin e zakonshëm të saj si edhe të drejtën për të miratuar të gjitha vendimet që i gjykon të përshtatshme për arritur dhe përbushur qëllimin e shoqërisë, me përashtim të vendimeve që me ligj i takojnë Asamblesë së Ortakëve.

Administratori mund të autorizojë palë të treta për ta përfaqësuar atë në transaksione të veçanta me anë të një prokure të hartuar para noterit.

8.4 Personi i mëposhtëm do të caktohet si Administrator i Shoqërisë për një afat **5 vjeçar** për të gjithë periudhën e kohëzgjatjes së shoqërise:

Z. Ergys Pasha, shtetas shqiptar, e biri i Hysni, i datëlindjes 31.08.1992, lindur në Burrel dhe banues në Fushë Krujë, mbajtës i pasaportes me numër BF0561420 dhe numër personal J20831004P, lëshuar nga Ministria e Brendshme datë 08.07.2024.

9. PRISHJA DHE LIKUJDIMI I SHOQËRISË

Prishja dhe likujdimi i shoqërisë tregtare mund të bëhet në çdo kohë dhe për çfarëdo shkaku ligjor, duke përfshirë dhe falimentimin, pavlefshmëria e themelimit të shoqërisë të parashikuar nga ligji, për çdo shkak tjetër të vendosur me vullnetin e ortakëve të shoqërisë.

10. TË NDRYSHME

Akti i themelimit të shoqërisë u përpilua në 2(dy) ekzemplarë, njëra për tu dorëzuar pranë organeve kompetente dhe tjetra do të mbetet në dosjen e dokumentacionit të krijimit të shoqërisë "PASHA RENTAL" sh.p.k

Akti i themelimit të shoqërisë nënshkruhet tregullisht nga ortakët themelues .

ORTAKËT THEMELUES

E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

"PASHA RENTAL " Sh.p.k

ERGYS PASHA 